

në shtëpi. Musa u rikthye në **Carrabregun e Epërm/Gornji Crnobreg** më **9.06.1998**, që axhës t'i çonte ushqim. E luste që të niset me të, por Elazi e refuzoi. Forcat serbe kanë hyrë në fshat më 11.06.1998, kështu që Musa nuk guxonte më ta vizitonte axhën. Në shtator të vitit 1998, kur situata u qetësua pakëz, Musa u rikthye sërish në fshat, kësaj radhe me familjen e tij. Në oborrin e shtëpisë, e ka gjetur të varrosur trupin e axhës. Në një lis përkaj varrit, e ka gjetur një thikë me gjurme të gjakut. Me ndihmën e të afërmeve, ai e ka varrosur trupin e axhës në bahçen që gjendet në afërsi të shtëpisë familjare. Në maj të vitit 2000, familja i ka rivarrosur mbetjet mortore të Elazit në varrezat lokale.

**Burimi:** deklarata M.D, FDH-17905.

### Jakup (Abaz) Dautaj

(15.02.1941, shqiptar nga Carrabregu i Epërm/Gornji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, pesë fëmijë)

Jakupi i kishte tre djem dhe dy vajza. Djalin Hamdiun ia kishin vvarë më 3.06.1998 në hyrje të fshatit Prilep [të shikohet regjistrimi]. Nga kjo ditë, Jakupi shkante për ditë në Prilep në përpjekje për ta gjetur trupin e të birit. Në datën 12.06.1998, u nis me djalin Bedriun. Nga ora 18:00, arritën në hyrje të fshatit **Prilep**. Forcat serbe hapën zjarr ndaj tyre dhe e qëlluan Jakupin me dy plumba. Djali e ka çuar menjëherë në spitalin e UÇK-së në Irzniq/Rzniç, ku i dhanë ndihmën e parë. Nga fundi i muajit korrik, familjarët e kanë çuar Jakupin në fshatin Broliq/Brolić [Pejë/Peć], ku për të u kujdeseshin mjekët e UÇK-së. Por, plagët e tij u infektuan dhe ai më 12.09.1998 ndërroi jetë. Familjarët e kanë varrosur në varrezat në Broliq/Brolić, ku prehet edhe sot.

**Burimet:** deklarata B.D, FDH-40573; J. Osmani, *Krimet...*, I, 131.

### Kujtim (Muharrem) Gjukaj

(9.07.1978, shqiptar nga Strellci i Ulët/ Donji Streoc, komuna e Deçanit/Deçani, pjesëtar i UÇK-së)

Kujtimi me të vëllain Avniun dhe babanë Muharremin aderuan në UÇK në fillim të

marsit të vitit 1998. Në datën **13.06.1998**, Kujtimi u plagos në betejë me forcat serbe në **Isniq/Istinić**. I ati dhe i vëllai e kanë çuar në spitalin e fshatit Prapaqan/Papraçane, por Kujtimi ndërroi jetë pas disa orësh, për shkak të plagëve të rënda. Ditën e nesërme dhe me ndihmën e disa pjesëtarëve të UÇK-së, ai u varros në varrezat e fshatit Strellc i Ulët/ Donji Streoc. Atje prehet edhe sot.

**Burimet:** deklarata H.G, FDH-29920; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

### Gani (Musë) Balaj

(18.11.1960, shqiptar nga Isniq/Istinić, komuna e Deçanit/Deçani, punëtor, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

### Xhafer (Musë) Balaj

(24.11.1971, shqiptar nga Isniq/Istinić, komuna e Deçanit/Deçani, pjesëtar i UÇK-së)

Ganiu punonte në fabrikën e Irzniqit/Rznić, ndërkaq me vëllain më të vogël, Xhaferin jetontin në Isniq/Istinić. Që të dy aderuan në UÇK menjëherë në fillim të luftës. Ganiu e kryente detyrën e komandantit të njësitit të fshatit. Më **13.06.1998**, ata kanë rënë në luftimet me forcat serbe që u zhvilluan në **Isniq/Istinić**.

**Burimet:** J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

### Tahir (Rexhep) Alaj

(16.02.1940, shqiptar nga Drenoci/Drenovac, komuna e Deçanit/Deçani, zanatli, gjashtë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Tahiri merrej me përpunimin e drurit dhe e kishte një punëtor zdrukthëtarie të quajtur *Ligjet e Gjeravicës/Zakoni Deravice*. Familja e tij u largua nga Drenoci/Drenovac më 2.06.1998 dhe ka shkuar në Shqipëri. Tahiri ka mbetur vetëm në shtëpi. Në shtator të vitit 1998, familja e Tahirit u kthye nga Shqipëria, por nuk e gjeti atë në shtëpi. Pas përfundimit të luftës, familja kishte mësuar nga një qytetar i Pejës/Peć se ai, duke vepruar sipas urdhrat të forcave serbe, më 16.06.1998, e kishte varrosur Tahirin, të cilin e njihte, në varrezat e qytetit të Pejës/Peć. Në datën 23.09.1999,